



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Elite Premium Bau" Sh.P.K. të datës 13.06.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "109 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve fekale në tërë fshatrat e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4299-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Elite Premium Bau" Sh.P.K. e datës 13.06.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "109 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve fekale në tërë fshatrat e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4299-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Elite Premium Bau" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 13.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "109 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve fekale në tërë fshatrat e Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4299-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.



**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** "Ak ne baz te kerkesave specifike te dosjes se tenderit per kanalizim ka kerkuar kriteret te cilat nuk perkojn per fushen e kanalizimit siq janë: -Tre (3) Saldues për gyp HDPE, të çertifikuar sipas EN-13067. kur dihet qe gypat e kanalizimit nuk saldohen per qfar arsye duhen keta te çertifikuar ky eshte kriter diskriminues se mundet me i pas ndonje oe tjetër dhe e favorizon po te ishin te nevojshum nuk do te ishte problem Po ashty tek paisjet teknike jan kerkuar pajisje qe nuk perkojn me gypat e kanalizimit : gjysem-rimorkio kompresor me libreze Aparat per testimin e gypave EN805/W400 Prerese – thike per prerjen e gypave nga PVC, TL 225 Kerkojm nga AK qe keto kriteret te largohen per arsye se per projektin ne fjal janë te pa nevojshme".

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit,** fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Tutje përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet.

Të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit janë përcaktuar në koordinim të plotë me njësinë kërkuese. Si të tilla këto kërkesa të dosjes së tenderit jo vetëm që janë në përputhje të plotë me qëllimin e projektit dhe nevojat e njësisë kërkuese, por janë edhe të domosdoshme që të realizohet me sukses, pra në mënyrë efikase dhe efektive kontrata që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka prezantuar asnjë argument pse këto kërkesa të dosjes së tenderit nuk janë të lejuara sipas LPP në fuqi duke mbështetur argumentet në prova apo dëshmi konkrete.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 24.06.2024**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.